



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ 2021

**VENDIM**  
**Nr. 556, datë 01.12.2021**

**PËR**  
**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT I PËR**  
**VITIN 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit \_\_\_\_\_, për vitin 2019”, i hartuar nga relatore znj. Brunilda Kadi,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit \_\_\_\_\_, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

## ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

### 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

## 1-A Njohuritë ligjore.

### *1-A-a Afërsia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.*

Nga vëzhgimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore, në 6 çështjet e përzgjedhura me short, evidentohet se gjyqtari ka njohje dhe zbatim korrekt të ligjit material dhe procedural penal, të referuar në mbështetje të vendimeve të ndërmjetme, gjatë zhvillimit të seancave dhe në përfundim të tyre.

*Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes.* Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari në vendimet përfundimtare, në pjesën përshkruese arsyetuese, fillimisht paraqet ecurinë dhe elementë proceduralë, kërkesat paraprake dhe vendimin e gjykatës në lidhje me to. Në vijim, në një nëndarje të veçantë, paraqet faktet e çështjes penale, ashtu si kanë rezultuar të provuara gjatë gjykimit. Mënyra e përshkrimit të rrethanave të çështjes, në disa raste, nuk rezulton të jetë si një fakti nxjerrë/formuar nga përmbajtja e provave në mënyrë të integruar, por duke cituar gjithë përmbajtjen e provës përkatëse (*si deklarimet e të pandehurit apo të personave nën hetim*, etj). Në raste të tjera, në çështje penale themeli, përshkruan faktet e çështjes në përputhje dhe të integruara me provat e administruara në gjendjen në të cilën janë aktet, në rastet kur është proceduar me gjykim të shkurtuar. Në kërkesat penale për vleftësim dhe caktim mase sigurie, përshkruan faktet e çështjes në përputhje me provat e administruara *deri* në fazën e shqyrtimit të kësaj kërkesë. Në këtë pjesë të arsyetimit gjyqtari bën analizë të provave të marra në gjykim dhe të fuqisë së tyre provuese, në funksion të përcaktimit të konkluzionit mbi ekzistencën ose jo të faktit penal, apo cilësimit juridik të veprës penale.

*Në lidhje me përcaktimin e natyrës së çështjes.* Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit konstatohet se gjyqtari, në 8 vendimet e vëzhguara (6 dosjet e përzgjedhura me short dhe 2 të përzgjedhura nga vetë gjyqtari), përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, si në çështjet e themelit ashtu edhe në kërkesat e tjera penale si : *dërgim në gjyq të çështjes penale, masa sigurimi*. Përcaktimi i qartë i natyrës së çështjes nga gjyqtari, shërben për organizimin e arsyetimit ligjor të vendimit në drejtim të identifikimit, dhe më tej argumentimit të çështjes/ve thelbësore të nevojshme për tu analizuar në raport me natyrën e çështjes.

*Në lidhje me përcaktimin e ligjit të zbatueshëm.* gjyqtari evidenton qartë ligjin, material dhe atë procedural penal, duke cituar të gjitha dispozitat që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Në bazë të kategorisë së çështjes objekt gjykimi, gjyqtari përcakton në fillim të pjesës përshkruese arsyetuese të vendimit, elemente që kanë të bëjnë me procedurën e ndjekur nga gjykata. Më pas vijon me rrethanat e faktit të çështjes, të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat e administruara gjatë gjykimit. Pasi përshkruan faktet e çështjes, gjyqtari përcakton ligjin e zbatueshëm, duke cituar ligjin procedural/material që zbatohet në çështjet objekt gjykimi.

*Sa i përket konfliktit të normave,* në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, konstatohet se në 4 nga 8 prej tyre, e që i përkasin çështjeve penale për *dërgim në gjyq të çështjes penale,*

gjqytari identifikon dhe analizon konfliktin e normave procedurale penale. Ky konflikt lidhet me *afatin* dhe marrjen në shqyrtim të çështjes në seancë paraprake, konkretisht nenet 332 pika 2 dhe 334/a të K.Pr.Penale, të cilët trajtojnë të njëjtën çështje, por në mënyra diametralisht të kundërta, sipas interpretimit dhe analizës së bërë nga gjyqtari.

Në tërësi, referuar të dhënave që evidentohen nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi secilin fakt, citimin dhe analizën e normave respektive, analizimin nga pikëpamja e ligjit dhe e provave të vendimit të dhënë nga Gjykata.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

#### *1-A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.*

Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit konstatohet se gjyqtari, referon, citon dhe interpreton normat e ligjit procedural dhe material të zbatueshëm mbi faktet e çështjes, në shërbim të analizës ligjore dhe zbatimit të tyre në zgjidhjen e çështjes konkrete.

*Në lidhje me interpretimin e ligjit të zbatueshëm.* Në vendimet gjyqësore të vëzhguara, konstatohet se gjyqtari, jo vetëm citon dispozitën ligjore të zbatueshme, materiale/procedurale penale, por analizon dhe interpreton ato në kuadër të fakteve të çështjeve objekt gjykimi, duke zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale dhe procedurale që gjejnë aplikim në çdo rast konkret. Gjyqtari interpreton dispozitat në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e veprës, interpreton normën, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale si dhe duke i ndërthurur me faktet dhe provat e rezultuara gjatë gjykimit, në funksion të konkluzioneve të arritura. Në vendimet e vëzhguara evidentohet se gjyqtari, fillimisht analizon dhe interpreton institutin dhe normat relevante që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes, *në aspektin teorik/abstrakt të saj*, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Pas kësaj analize dhe interpretimi teorik/abstrakt, gjyqtari referon në rastin konkret dhe interpreton normën në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.

Nga vendimet e vëzhguara, evidentohet se gjyqtari citon dhe interpreton normën juridike që zbatohet në zgjidhjen e çështjes, e konkretisht: *interpreton nenet 403 e vijues të K.Pr.Penale, të ndryshuar, mbi procedimin e çështjes me ritin e gjykimit të shkurtuar, në lidhje me kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen për pranimin e kërkesës; identifikon dhe interpreton nenin 4, 152 dhe 388 të K.Pr.Penale; interpreton në mënyrë literale dispozitën materiale penale, nenin 262/2 dhe 293 të K.Penal në funksion të cilësimit juridik të veprës penale për të cilat akuzohet i pandehuri; duke qenë se neni 262/2 i K.Penal është një dispozitë blanket, gjyqtari i referohet dhe interpreton për këtë qëllim edhe dispozitat e ligjit të posaçëm, nr.*

8145 datë 11.09.1996 "Per të drejtën e tubimeve" i shfuqizuar dhe ligjin e zbatueshëm në fuqi nr. 8773 datë 23.04.2001 "Per tubimet"; bën interpretim pajtues me Kushtetutën, të nenet 2 dhe 332/a të K.Pr.Penale të cilët trajtojnë të njëjtën çështje, por në mënyra diametralisht të kundërta; interpreton të gjitha dispozitat e ndryshuara (shtuara me ligjin 35/2017) mbi gjyqtarin e seancës paraprake duke përcaktuar elementët e seancës paraprake në funksion të përcaktimit të funksionit dhe qëllimit të kësaj faze të re procedurale; dispozitat procedurale penale të ndryshuara, nenet 332 e vijues të K.Pr.Penale mbi dërgim e çështjes në gjyq; interpreton dispozitat procedurale penale të ndryshuara, nenet 328, 329/a e vijues të K.Pr.Penale mbi pushimin e akuzës apo të çështjes penale; interpreton nenin 283/1 të K.Penal, në mënyrë literale; interpreton nenin 283/1 të K.Penal dhe ligjin e posaçëm në të cilën të referon dispozita blanket; interpreton ligjin për barnat narkotike dhe psikotrope; interpreton dispozitat materiale dhe rrethanat që ndikojnë në individualizimin e dënimit për të pandehurin, nenet 47 dhe 48 të K.Penale; interpreton në mënyrë teleologjike nenin 251 e vijues të K.Pr.Penale, e duke cituar për këtë qëllim edhe parimet e përmbajtura në KEDNJ; interpreton nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale; interpreton nenin 89 të K.Penal.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante. Në të gjitha vendimet e analizuara, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve dhe në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit.

Konkretisht në 8 vendimet e vëzhguara gjyqtari citon, analizon dhe interpreton: vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 5/2001; nr. 8/2005; nr. 10/2009; nr. 9/2010; nr. 20/2011; nr. 47/2011; nr. 4/2012; nr. 24/2012; nr. 57/2012; nr. 45/2013; nr. 16/2015; nr. 22/2015; nr. 4/2016; nr. 20/2016 dhe nr. 56/2016; Vendimet Unifikuese nr. 2/2003; nr. 7/2011; n.2/2013, nr. 3/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; Vendimet nr. 8/2012; nr. 201/2012; nr. 31/2013; nr. 97/2013; nr. 196/2013 dhe nr. 125/10.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; praktike të GJEDNJ konkretisht: çështja "Kudrevicius dhe të tjerë kundër Litanisë", Vendim i Dhomës së Madhe të Gj.E.D.NJ, datë 05.01.2016; çështja "Frumkin kundër Rusisë" Vendim i Dhomës së Madhe të Gj.E.D.NJ, datë 05.01.2016; çështja "Salabiaku kundër Francës", Vendimi i Gj.E.D.NJ, datë 07.10.1988; çështja "A.M. kundër Italisë", Vendimi i Gj.E.D.NJ, ECHR 1999-LX; çështja "Breukhoven kundër Republikës Çeke", Vendimi i Gj.E.D.NJ, datë 21.07.2011.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës. Në vendimet e vëzhguara, evidentohet se gjyqtari i kushton një rëndësi të veçantë citimit dhe zbatimit të parimeve të përgjithshme të së drejtës, e veçanërisht ato që i përkasin të drejtës penale materiale dhe procedurale, e konkretisht; parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin procedural penal përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, parimin e kushtetutshmerisë, parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, parimin e ligjshmerisë, parimin e nullum crimen, nulla poena sine legge, parimin e nullum crimen, nulla poena sine culpa, etj.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë për të interpretuar ligjin në funksion të zgjidhjes së çështjes.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

## **I-B Arsyetimi ligjor**

### ***I-B-a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.***

Vendimet gjyqësore të vëzhguara të gjyqtarit janë të organizuara sipas një strukture të qartë dhe standardizuar, (pjesa hyrëse, arsyetuese, dispozitivi). Në pjesën hyrëse vendimet përmbajnë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve, dhe përfaqësuesve të tyre, objektin dhe bazën ligjore si dhe kërkimet përfundimtare të palëve. Pjesa përshkruese arsyetuese, është e organizuar sipas një strukture të standardizuar me nënndarje. Fillimisht analizohen rrethanat procedurale, më pas përshkruhen rrethanat e faktit, përcaktohet ligji i zbatueshëm dhe më pas vlerësimi i gjykatës nëpërmjet aplikimit të ligjit të zbatueshëm mbi faktet objekt gjykimi. Dispozitivi i vendimeve është i plotë i qartë dhe konkret. Në veprimet për drejtimin e seancave gjyqësore dhe vendimet përfundimtare, përdoret një gjuhë e thjeshtë, e qartë dhe e drejtpërdrejtë.

Gjyqtari përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, respekton rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës, shenjat e pikësimit, thonjëzat dhe simbole të tjera, duke i bërë vendimet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte në aspektin *gjuhësor*. Fjalitë janë me gjatësi mesatare dhe ndërtohen në një mënyrë të tillë që të transmetojnë mendimin dhe të lidhen me njëra –tjetrën për nga vijimësia e kuptimit. Teksti i vendimeve është i organizuar në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë së mendimit.

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht në ligjet e posaçme apo në aktet e ekspertimit. Ndërkohë, në shkrimin e vendimeve të vëzhguara, konstatohet edhe përdorimi i termave dhe shprehjeve në gjuhën latine, ndonjëherë të panevojshme dhe të pa shpjeguara në gjuhën shqipe.

Një karakteristike në shkrimin e vendimeve përfundimtare të gjyqtarit është jo vetëm citimi, por edhe vendosja e përmbajtjes së plotë të dispozitave materiale apo procedurale. Gjithashtu, shpesh gjyqtari vendos përmbajtjen e plotë të provave të marra në shqyrtim, të cilat mund kufizoheshin vetëm në ato pjesë që është e rëndësishme për argumentin.

Një karakteristike tjetër e shkrimit të vendimeve përfundimtare, është përdorimi i shënimeve fundore, ndërkohë që vendimi gjyqësor duhet të jetë i qartë dhe nuk duhet të ketë nevojë për shpjegime shtesë.

Në vendimet përfundimtare të vëzhguara, evidentohet gjithashtu që gjyqtari bën edhe interpretime abstrakte dhe teorike të ligjit dhe instituteve ligjore. Vendimet, veçanërisht ato të përzgjedhura nga vetë gjyqtari, janë relativisht të gjata (50 - 65 faqe), dhe kjo pasi në

arsyetimin e vendimeve analizohen koncepte të së drejtës dhe institute të cilat, të cilat në thelb ia rrisin vlerën një vendimi gjyqësor në kuptimin akademik të tij.

Gjithashtu evidentohet se gjyqtari njih mirë praktikën gjyqësore vendase dhe të huaj duke elaboruar dhe duke bërë pjesë të arsyetimit të vendimit edhe pjesë nga kjo jurisprudencë por, nga ana tjetër konstatohet se gjyqtari nuk limitohet thjeshtë në konkluzionin e arritur nga kjo jurisprudencë por, duke cituar pasazhe të tëra të saj në përmbajtje të arsyetimit të vendimit.<sup>1</sup>

Prezenca e të gjithë këtyre elementëve, gjithsesi vlerësohet nga Këshilli se nuk cenon qartësinë dhe kuptueshmërinë e vendimit.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### ***I-B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.***

Gjyqtari i harton vendimet e tij me strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar. Vendimet e vëzhguara respektojnë me rigorozitet strukturën formale me tre pjesë të vendimit, por edhe elementët e çdo pjesë, siç përcakton neni 383 i Kodit të Procedurës Penale. Çdo vendim gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit dhe gjykata që ka gjykuar çështjen, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit dhe baza ligjore, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve të pranishme në proces.

*Në pjesën përshkruese-arsyetuese* gjejnë pasqyrim në mënyrë të strukturuar procedura e ndjekur, faktet e çështjes siç rezultojnë nga provat, ligji i zbatueshëm dhe vlerësimi i gjykatës, ku merret në analizë ligji i zbatueshëm, elementët e tij në lidhje me faktet konkrete, dhe në fund konkluzioni i gjyqtarit për zgjidhjen e çështjes. Në këtë pjesë të vendimit, evidentohet gjithashtu interpretimi teorik/abstrakt që gjyqtari i bën dispozitive penale materiale dhe procedurale dhe instituteve të ndryshme të kësaj fushe të së drejtës.

*Në pjesën e dispozitivit* gjen pasqyrim disponimi i gjykatës për zgjidhjen e çështjes, shpenzimet gjyqësore, si dhe e drejta e ankimit. Përsa i takon dispozitivit të vendimit, gjyqtari përdor teknikën e listimit të disponimeve duke i numërtuar ato, që lehtëson referencat në rastin kur vendimi ka disa disponime.

Struktura e vendimit dhe nënndarjet, janë në harmoni me njëra - tjetrën dhe në rrjedhë logjike në shërbim të konkluzioneve të arritura në vendim. Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, koncize, e thjeshtë dhe e kuptueshme.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

<sup>1</sup>Konstatohet se në vendimin nr. 1500 datë 11.06.2019, citohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane nga fq 11-16 të vendimit, apo vendimin e GJEDNJ-se nga fq 17- 30 të vendimit.

### *I-B-c Cilesia e analizës dhe argumentimit logjik.*

Në vendimet gjyqësore të vëzhguara konstatohet se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të analizës dhe argumentimit logjik. Gjyqtari, identifikon dispozitat ligjore, shtjellon argumentat e gjykatës në mënyrë logjike, duke paraqitur një analizë të plotë të fakteve të çështjes, sëbashku me provat mbi të cilat ato mbështeten, si dhe paraqet argumentat në lidhje me bazueshmërinë ose jo të kërkimeve objekt gjykimi.

Në të gjitha vendimet e vëzhguara, gjyqtari analizon faktin penal duke e lidhur drejtpërdrejtë me elementët e figurës së veprës penale apo kushtet procedurale për aplikimin e procedurës së gjykimit të shkurtuar, apo të pushimit të akuzës. Ai argumenton në mënyrë logjike përjasjen e fakteve të provuara në gjykim me ligjin e zbatueshëm, kuptimin e tij nëpërmjet interpretimit dhe duke identifikuar lidhjen shkak-pasojë, mes faktit, ligjit dhe konkluzionit në zgjidhjen e çështjes. Analizon dhe individualizon përgjegjësinë penale të autorit të veprës penale, të drejtat e të pandehurit në procesin penal, rrethanat e faktit penal në përputhje me provat, si dhe rrethanat për caktimin e dënimit penal. Jep arsye të qarta për konkluzionet që nxjerr, duke i kushtuar rëndësi edhe pretendimeve të palëve që nuk pranohen nga gjykata.

Citon dispozitën ligjore të zbatueshme dhe jep argumentet përse kjo dispozitë është e zbatueshme në çështjen konkrete. Kur është rasti, i plotëson argumentet edhe me referenca në parimet e përgjithshme të së drejtës, si dhe në jurisprudencën e gjykatave më të larta. Rrjedhimisht, të gjitha disponimet e gjykatës janë të lidhura me pjesën arsyetuese.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë". duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## **2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.*

## 2.A Aftësia e gjyqtarit për të përbulluar ngarkesën në punë.

### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari ka gjykuar në total 315 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 121 ose 38.4 % të tyre janë gjykuar jashtë këtij afati.

Për të vlerësuar këtë tregues, sipas metodologjisë së miratuar nga këshilli, këto të dhëna statistikore duhet të analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari në lidhje me këtë tregues shpjegon se: *“Sipas analizës vjetore të vitit 2019 që më është vënë në dispozicion rezulton se unë kam gjykuar rreth 591 çështje po aq sa më janë shortuar brenda vitit 2019. Theksohet se viti 2019 është viti ku sipas analizës vjetore është trefishuar ngarkesa në punë e gjyqtarëve. Sipas sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës penale, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në një vit, në jo më pak se 100 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundravajtje penale). Sipas këtyre të dhënave statistikore, konstatohet se ngarkesa sasiore e imja si gjyqtar për vitin 2019 është 591 çështje pothuajse pesë herë më e lartë se standardi ligjor. Pavarësisht ngarkesës tejte të lartë, nga ana ime janë marrë të gjitha masat për t'i përfunduar çështjet brenda afatit ligjor dhe afateve të vendosura nga KLGJ-ja. Krahas marrjes së masave për t'i përfunduar çështjet brenda afatit ligjor nga ana ime janë respektuar të gjitha dispozitat procedurale për realizimin e njoftimeve dhe dhënies së palëve të kohës së nevojshme për të realizuar një mbrojtje efektive. Kështu, përsa i përket njoftimeve nga ana ime është mbajtur parasysh dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin Nr. 30, datë 17.06.2010, ku ndër të tjera është shprehur se: “Dispozitat procedurale për njoftimet vendosin një rend të caktuar për mënyrën e njoftimit të akteve për të pandehurin, prandaj duhet respektuar rendi sipas preferencës ligjore për këtë qëllim. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin.”. Sipas kësaj jurisprudence duhet të realizohen të gjitha mënyrat e njoftimit deri në realizimin e shpalljes publike, në të kundërt procesi është nul. Natyrisht ndjekja e të gjitha procedurave për realizimin e njoftimeve mund të ndikoj në kohëzgjatjen e procesit, por kjo është një kërkesë e detyrueshme e ligjit që duhet zbatuar nga gjykata. Numri i çështjeve që mund të ketë kaluar afatin ligjor për përfundimin e gjykimit duhet të jetë shumë i vogël në raport me numrin çështjeve të shortuara dhe të gjykuara brenda vitit 2019. Kur është konstituar procesi unë gjykimin e kam përfunduar brenda një ose dy seancave kur është procesi është zhvilluar me procedurën e gjykimit të shkurtuar. Faktorët që mund të kenë ndikuar në mos gjykimin brenda afatit ligjor nuk lidhet me sjelljen e gjyqtarit, por janë të lidhur me: i) mungesën e prokurorit të çështjes për shkaqe të ndryshme pa të cilin nuk zhvillohet procesi sipas neni 128 dhe 342 të K.Pr.Penale; ii) nuk realizohet njoftimi i palëve dhe dëshmitarëve për shkak të*

adresave apo moskonfirmimit nga posta apo oficerët e policisë gjyqësore; iii) mungesës së palëve të tjera për shkak të arsyeshme apo të paarsyeshme por që duhet të ndërmerren hapa për deklarimin e mungësës, caktimin e një avokati kryesisht dhe marrjen e kohës për studimin e dosjes nga ky gjyqësori, me qëllim realizimin e një mbrojtje efektive; iv) pamundësia për të caktuar një seancë tjetër sa më shpejt për shkak të ngarkesës së madhe në punë; v) kompleksiteti i çështjeve kur numri i të pandehurve ka qenë shumë i madhe dhe mungesa qoftë e njërit prej tyre ose e mbrojtësit passjell shtyrjen e seancës; vi) pezullimi i gjykimit të çështjeve për shkak se i pandehuri nuk merrë dijen personalisht për zhvillimin e gjykimit sipas nenit 352 të K.Pr.Penale i ndryshuar me Ligjin Nr. 35/2017; vii) trajnimet vazhduese në Shkollën e Magjistraturës, si dhe shkaqe të tjera objektive të pavarura nga vullneti i gjykatës.”

Gjithashtu, gjyqtari \_\_\_\_\_, ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesën me objekt; “1. Mbi arsytet e përfundimit të afatit ligjor ose standardit minimal kohor të çështjeve për periudhën e vlerësimit. 2. Pasqyrimin në raportin e vlerësimit të arsyeve të përfundimit të afatit ligjor ose standardit minimal kohor të çështjeve që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, e cila mund të çojë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së miratuar me vendimin Nr. 264, datë 21.11.2019 “Për miratimin “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, deri në pikëzimin maksimal. Kërkesë të cilën e ka shoqëruar sëbashku me dokumentacionin provues, gjithsej 1213 (një mijë e dyqind e trembëdhjetë) fletë”.

Në analizë të këtyre shpjegimeve dhe akteve që i shoqërojnë, rezulton se: nga 54 çështje të gjykuara jashtë afatit ligjor, për të cilat gjyqtari \_\_\_\_\_ ka dhënë shpjegime të arsyeshme dhe të pranueshme, 3 prej tyre, (konkretisht çështjet me nr. rendor 49, 50 dhe 81 të Tabelës Nr. 11, për kategorinë e çështjeve “Seanca paraprake”) nuk i përkasin kësaj kategorie, pasi sipas tabelave me të dhëna statistikore këto 3 çështje janë gjykuar brenda këtij afati. Ndërkohë, duke zbritur nga numri total 121, 51 (54-3) çështje të gjykuara jashtë afatit ligjor, (për të cilat gjyqtari \_\_\_\_\_ ka dhënë shpjegime të arsyeshme dhe të pranueshme), rezulton se numri i këtyre çështjeve shkon në 70 ose 22.2% .

Gjithashtu, duhet marrë parasysh edhe;

- a) përjashtimin nga kjo periudhë, kohën që mund të ketë marrë lëvizja e dosjes nga momenti i regjistrimit deri te shortimi dhe dorëzimi te gjyqtari,
- b) kohën që i është dashur gjyqtarit për shtyrje të gjykimit për shkaqe të pavarura prej tij, si është njoftimi dhe respektimi i të drejtave të tjera të palëve,
- c) ngarkesën e gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit, nga ku rezulton se ai ka gjykuar *disa herë më shumë* se numri i çështjeve, sipas standardit minimal sasior të punës, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, dt 14.04.2010, të KLD-së.
- d) kompleksitetin e çështjeve dhe rritjen e papritur të volumit të çështjeve,
- e) si dhe faktit se në disa raste, sipas të dhënave statistikore, konstatohet se tejkalimi i afatit ligjor është për një kohë relativisht të shkurtër (1-2 ditë), dhe që nuk i përkasin atyre çështjeve për të cilat gjyqtari \_\_\_\_\_ ka dhënë shpjegime, në lidhje me këtë tregues, gjyqtari vlerësohet në nivelin “Mbi mesatar”, duke u pikëzuar më 12 pikë.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Mbi mesatare", duke e pikëzuar me 12 pikë.

#### **2.A.5 Plotësimi i standardeve minimale kohore.**

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari ka gjykuar në total 270 çështje, për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal. Nga këto 46 ose 17 % të tyre, janë gjykuar jashtë këtyre afateve.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari në lidhje me këtë tregues shpjegon se: *"Duke përjashtuar faktorët që janë të pavarur nga vullneti i gjyqtarit mund të them se nga ana ime janë bërë të gjitha përpjekjet për të respektuar standardet minimale kohore."*

Gjithashtu, gjyqtari F [redacted], ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesën me objekt; *"1. Mbi arsyet e përfundimit të afatit ligjor ose standardit minimal kohor të çështjeve për periudhën e vlerësimit. 2. Pasqyrimin në raportin e vlerësimit të arsyeve të përfundimit të afatit ligjor ose standardit minimal kohor të çështjeve që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, e cila mund të çojë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së miratuar me vendimin Nr. 264, datë 21.11.2019 "Për miratimin "Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit", deri në pikëzimin maksimal. Kërkesë të cilën e ka shoqëruar sëbashku me dokumentacionin provues, gjithsej 1213 (një mijë e dyqind e trembëdhjetë) fletë"*

Në analizë të këtyre shpjegimeve dhe akteve që i shoqërojnë, rezulton se gjyqtari ka dhënë shpjegime të arsyeshme dhe të pranueshme, për 14 prej tyre. Duke zbritur nga numri total 46, këto 14 çështje, numri i tyre shkon në 32 ose 11.8% .

Gjithashtu, duhet marrë parasysh edhe;

- a) përjashtimin nga kjo periudhë, kohën që mund të ketë marrë lëvizja e dosjes nga momenti i regjistrimit deri te shortimi dhe dorëzimi te gjyqtari,
- b) kohën që i është dashur gjyqtarit për shtyrje të gjykimit për shkaqe të pavarura prej tij, si është njoftimi dhe respektimi i të drejtave të tjera të palëve,
- c) ngarkesën e gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit, nga ku rezulton se ai ka gjykuar *disa herë më shumë* se numri i çështjeve, sipas standardit minimal sasior të punës, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, dt 14.04.2010, të KLD-së dhe
- d) kompleksitetin e çështjeve dhe rritjen e papritur të volumit të çështjeve,
- e) diferencën e vogël në kohë të kalimit të standardit minimal kohor, në lidhje me këtë tregues, gjyqtari pikëzohet në nivelin maksimal.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 5 pikë.



## **2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje.**

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër ose e barabartë se standardi minimal kohor i miratuar, për të gjitha kategoritë e çështjeve.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 5 pikë.

## **2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore nga gjyqtari është 100 %.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

## **2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.**

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar është si më poshtë vijon:

- Për çështje të kategorisë "*kërkesa penale të hetimit paraprak*" për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt vlefësim arresti dhe caktim mase sigurimi si dhe zëvendësim apo revokim mase sigurimi, koha mesatare e arsyetimit është 7.93 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 249 dhe 260 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë "*kërkesa penale të hetimit paraprak*" për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt verifikim kushtesh dhe kriteresh (neni 248/2 K.Pr.Penale) apo shuarje e masave të sigurimit (neni 261/3 i K.Pr.Penale), koha mesatare e arsyetimit është 3 ditë, pra më e gjatë se afati procedural prej 48 orë i parashikuar nga neni 248/2 dhe 261/3 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë "*kërkesa penale të hetimit paraprak*" për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt deklarim ikje apo kundërshtim vendimi mosfillimi, koha mesatare e arsyetimit është 16.3 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë "*penale krime*" koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 15.75 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë "*penale kundravajtje*" koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 20.38 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar

nga neni 430/1 i K.Pr.Penale.

- Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake – dërgim në gjyq*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 9.6 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh pg 3 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake – pushim procedimi*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 20.7 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural prej 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “*kerkesa penale në fazën e ekzekutimit*” për të cilën nuk parashikohet ndonjë afat i posaçëm për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 13.5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural prej 30 ditësh i parashikuar nga neni 430/1 i K.Pr.Penale.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari në lidhje me këtë tregues shpjegon se: “*Pavarësisht ngarkesës jashtëzakonisht të lartë në punë, numrin e lartë të çështjeve komplekse, si dhe numrit e lartë të çështjeve për të cilat parashikohen afate të shkurtra për arsyetim si: dërgim në gjyq (dhjetë ditë), masa sigurimit (pesë ditë), përgjime (24 orë), ekstradime (tre ditë) etj nga ana ime janë marrë të gjitha masat për të arsyetuar vendimin brenda afateve ligjore. Nëse do të shikohet koha e dorëzimit shumica prej tyre janë dorëzuar në një afat më të shkurtër se afati procedural i dorëzimit të tyre. Nëse ka pasur ndonjë rast për dorëzimin në sekretari me vonesë kjo ka ndodhur për shkak të pavarura prej meje. Kjo ka ndodhur për këto arsye: i) ndonëse nga ana ime është printuar vendimi dhe i është dhënë sekretarisë gjyqësore për të kryer veprimet e numërimit e qepjes së dosjes nuk është dorëzuar po atë ditë por një ose disa ditë më vonë për shkak të ngarkesës së madhe dhe kohës së nevojshme që i duhet për të bërë veprimet administrative. Fakti që unë i kam arsyetuar vendimet brenda afatit ligjor mund t'i provoje me email; ii) afati ligjor ka përfunduar në fundjave apo ditë pushimi, për rrjedhojë mund të jetë dorëzuar ditën e parë të punës që mund të jetë tej afatit ligjor kalendarik, por që duhet konsideruar se është dorëzuar në afat; iii) për shkak të mungesës në punë të sekretarisë gjyqësore për shkak të arsyeshme. Kjo ka bërë që dosjet të qepen dhe të dorëzohen pas disa ditësh pasi është kthye në punë; iv) pjesëmarrja ime në trajnimet vazhduese në Shkollën e Magjistraturës. Afati i fundit mund të ketë qëlluar pikërisht në këto ditë, për rrjedhojë afati ligjor shtyhet në ditën kur gjyqtari paraqitet në punë për nënshkrimin e vendimit; v) për shkak të infrastrukturës. Ka pasur raste që nuk ka pasur bojë printeri apo ka pasur mungesë në letër; vi) për arsye familjare gjyqtari nuk ka qenë në punë; vii) afati ligjor ka përfunduar kur gjyqtari ka qenë me leje, si dhe për shkak të tjera të pavarura nga gjyqtari.”. Ndërkohë gjyqtari nuk ka dhënë shpjegime konkrete për kategoritë e çështjeve për të cilat arsyetimi i vendimit përfundimtar gjyqësor ka rezultuar më i gjatë se afati procedural, duke e bërë të pamundur analizën mbi të dhënat statistikore.*

Përfundimisht, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor nga ana e gjyqtarit, është më e shkurtër se afati procedural, për shumicën e kategorive të çështjeve.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 12 pikë.

## 2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

### *2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.*

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numri i seancave gjyqësore është plotësuar në tabelat me të dhëna statistikore për çdo çështje dhe numri mesatar i tyre për kategori (çështjet me palë kundërshtarë) rezulton si më poshtë:

- 4.5 (katër presje pesë) seanca gjyqësore tek kategoria e çështjeve penale krime.
- 6.8 (gjashtë presje tetë) seanca gjyqësore tek çështjet e kategorisë kundravajtje penale.
- 2.6 (dy presje gjashtë) seanca gjyqësore tek çështjet e kategorisë seanca paraprake.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjes (duke përfshirur ato pa palë ndërgjyqëse) është 4.6.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, duke iu referuar Raportit Analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

- Gjyqtari në të gjitha çështjet e ka vënë në lëvizje dosjen në kohë dhe në përputhje me afatet ligjore;
- Vendimi për caktimin e seancës së parë është marrë brenda 10 ditëve, në respektim të parashikimeve të nenit 333/1 i K.Pr.Penale;
- Data e caktimit të seancës së parë gjyqësore, është bërë në respektim të afatit të parashikuar nga neni 333/2 të K.Pr.Penale;
- Seancat gjyqësore, në përgjithësi janë shtyrë duke respektuar afatin maksimal 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 të K.Pr.Penale;
- Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë;
- Në rastet kur seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues, gjyqtari ka marrë të gjitha masat që seancat vijuese të planifikohen në një kohë shumë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit.

Gjithashtu, në lidhje me kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale, në 6 dosjet e përzgjedhura me short, konstatohet se gjyqtari ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme për shmangien e seancave joproductive dhe seancat joproductive kanë ardhur jo si pasojë e veprimeve të gjyqtarit por, për shkaqe të tilla si; *mungesës së organit të akuzës, mosmarrjes dijeni në mënyrë efektive të të pandehurit, planifikimi i seancës ka rezultuar festë zyrtare, mungesës së gjyqtarit për arsye familjare, mungesës së gjyqtarit për shkak të pjesëmarrjes në trajnim të zhvilluar nga Shkolla e Magjistraturës.*

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtari në çdo rast ka marrë të gjitha masat e

nevojshme për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Prandaj, pavarësisht se numri mesatar i seancave është më i lartë se 3 në total për çështjet me palë kundërshtarë, gjyqtari pikëzohet në nivelin maksimal, pasi ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproductive.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### ***2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.***

Referuar; a) analizës së çështjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nga të cilat evidentohet se; gjyqtari në të gjitha çështjet e ka vënë në lëvizje dosjen në kohë dhe në përputhje me afatet ligjore, ka kryer veprimet procedurale të nevojshme të tilla si: për dosjet penale themeli, vendimi për caktimin e seancës së parë është marrë brenda 10 ditëve, në respektim të parashikimeve të nenit 333/1 i K.Pr.Penale, si dhe data e caktimit të seancës së parë gjyqësore, është bërë në respektim të afatit të parashikuar nga neni 333/2 të K.Pr.Penale. Seancat gjyqësore, janë shtyrë duke respektuar afatin maksimal 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 të K.Pr.Penale, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka qenë objektivist e pamundur. Gjithashtu, gjyqtari ka respektuar procesin e rregullt ligjor, duke orientuar debatin mes palëve, duke u shprehur me urdhra dhe vendime të ndërmjetme në lidhje me kërkesat e palëve, duke ndjekur të gjitha fazat e shqyrtimit gjyqësor, seancat kanë filluar në përgjithësi pa vonesë, dhe në ato raste në të cilat ka pasur vonesa, përgjithësisht është relatuar arsyeja e fillimit të tyre me vonesë, seancat gjyqësore përgjithësisht janë të regjistruara audio dhe b) burimeve të tjera të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarit janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 20 pikë.

#### **2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.**

##### ***2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.***

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarit renditja e akteve të dosjes gjyqësore është në atë mënyrë që e bën dosjen lehtësisht të shfrytëzueshme.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 5 pikë.

##### ***2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.***

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet që dokumentacioni në dosje, është në përputhje me veprimet procedurale të kryera, nuk ka mungesa, dhe se është i duhuri.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
94	Shkëlqyeshëm

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### 3.A Etika në punë

##### 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cenim të etikës apo përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksionit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje, apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit, gjatë ushtrimit të funksionit.

**Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 35 pikë.

#### 3.B Integriteti i gjyqtarit

##### 3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit si dhe **nuk** rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

**Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 40 pikë.

### 3.C Paanësia e gjyqtarit

#### 3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton që gjyqtari, të ketë përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit, si dhe në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

#### 3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se për gjyqtarin janë paraqitur 7 (shtatë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit, nga të cilat rezulton se 2 (dy) prej tyre janë pranuar dhe 5 (pesë) janë rrëzuar. Nga ana tjetër, rezulton se vetë gjyqtari ka paraqitur 5 (pesë) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat janë pranuar 4 (katër) dhe është rrëzuar 1 (një) prej tyre. Nga këto të dhëna, nuk rezulton që për gjyqtarin të ketë një numër tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e tij.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

#### 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### 4.A Aftësia e komunikimit.

###### *4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.*

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent, me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

###### *4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.*

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, presumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve, apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

**Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, gjyqtari në këtë tregues, vlerësohet në nivelin “Shumë i lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

##### 4.B Aftësia për të bashkëpunuar

###### *4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.*

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, presumohet se ai ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

###### *4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.*

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën

gjqësore, prezumohet se ai ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

#### **4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.**

##### ***4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.***

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari gjatë vitit 2019, ka marrë pjesë në programet e formimit vazhdues me cilësinë e ekspertit në 1 trajnim, në 2.5 ditë<sup>2</sup>, në cilësinë e lehtësuesit në 2 trajnime, në 6 ditë dhe në cilësinë e pjesëmarrësit, në 7 trajnime, përgjatë 13 ditëve. Kjo kohëzgjatje është brenda kufijve 5 deri në 40 ditë, në periudhën njëvjeçare të vlerësimit.

**Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 20 pikë.

##### ***4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.***

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari me vendimin Nr. 37, datë 28.02.2019 "*Për praktikën profesionale të Kandidatëve për Magjistrat të Shkollës së Magjistraturës*" të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është miratuar si Magjistrat Udhëheqës për një periudhë trevjeçare 2017-2020 me të drejtë riemërimi. Për periudhën 1 Nëntor 2018 - 28 Shkurt 2019 gjyqtari ka pasur në mentorim kandidatin për magjistrat z. \_\_\_\_\_ dhe për periudhën 1 Mars 2019- 30 Qershor 2019 ka patur në mentorim kandidatin për magjistrat z. !

Me vendimin Nr. 111, datë 09.07.2019 "*Për përditësimin e listës së Magjistratëve Gjyqtarë Udhëheqës për periudhën tre vjeçare 2017-2020*" të Këshillit të Lartë Gjyqësor gjyqtari Erjon Bani është bërë përsëri pjesë e listës së Magjistratëve Udhëheqës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë me vendimin Nr. 112, datë 09.07.2019 "*Për praktikën profesionale të Kandidatëve për Magjistrat të Shkollës së Magjistraturës për periudhën*

<sup>2</sup> Duke iu referuar nenit 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se: "*Per efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:*

- \* 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- \* 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- \* 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

*Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare".*

Korrik 2019 - Qershor 2020” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtari I udhëheqje Kandidatin për Magjistrat. Jeta Qinami.

ka pasur në

Gjithashtu, rezultojnë se gjyqtari gjatë vitit 2019, ka marrë pjesë me cilësinë e ekspertit, në 1 trajnim si dhe në cilësinë e lehtësuesit në 2 trajnime, në fushën e së drejtës materiale dhe procedurale penale, gjithsej 8.5 ditë.

**Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtari, vlerësohet me 5 pikë.

***4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari të marrëdhëniet me publikun në gjykata.***

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se për periudhën e vlerësimit, me vendimin Nr. 19, datë 03.10.2019 të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës gjyqtari është miratuar Pedagog në dispozicion në të “Drejtën Penale”, për Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020. Në dosjen personale nuk rezultojnë të dhëna nëse e ka ushtruar efektivisht mësimdhënien për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 - 31.12.2019. ndërkohë sipas vërtetimit nr. 501 Prot, datë 07.07.2021, të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, gjyqtari ka ushtruar efektivisht mësimdhënien në periudhën 10 shkurt – 22 maj 2020, e cila është jashtë periudhës së vlerësimit. Për periudhën e vlerësimit, evidentohet se gjyqtari I ka ushtruar funksionin e Kryetarit të Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë. Kjo veprimtari, referuar metodologjisë së pikëzimit, vlerësohet nga Këshilli si pjesëmarrje në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari të marrëdhëniet me publikun në gjykata. Për këtë arsye, gjyqtari për këtë tregues, pikëzohet me 5 pikë.

**Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 5 pikë.

***4.C.ç Publikimet ligjore akademike.***

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk evidentohet asnjë publikim ligjor i realizuar nga gjyqtari gjatë vitit 2019.

**Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE  
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

<b>Niveli i vlerësimit për çdo kriter</b>		
<b>Kriteri</b>	<b>Pikët</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	94	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
<b>Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit</b>		
Vlerësimi i përgjithshëm	389	Shkëlqyeshëm

**PROPOZIME DHE REKOMANDIME**

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, Këshilli rekomandon që gjyqtari Erjon Bani, të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstytucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYOËSOR**

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT, PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 01.01.2019-31.12.2019 I GJYQTARIT



1. AFTËSITË PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit	
				100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë		
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore te dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore te dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë	

					Shumë e lartë – 25 pikë
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore te dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore te dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore te dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE				Pikët total	Niveli i vlerësimit	
				94	Shkëlqyeshëm	
Tregues	Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia		
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi mesatare	12	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë	
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	5	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë	
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	5	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për	

					<p>gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë</p> <p>Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë</p> <p>Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë</p>
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<p>1. Të dhënat statistikore</p> <p>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</p> <p>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	Shumë e lartë	10	<p><b>Tej standardit :</b></p> <p>Nën 81 %- 2 pikë</p> <p>Mbi 81-87 % - 4 pikë</p> <p>Mbi 87- 93 % - 6 pikë</p> <p>Mbi 93-99 % - 8 pikë</p> <p>+99% - 10 pikë</p>
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<p>1. Të dhënat statistikore</p> <p>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</p> <p>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	Mbi mesatare	12	<p><b>Koha mesatare:</b></p> <p>Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë</p> <p>Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë</p> <p>Më e gjatë se afati</p>

					<p>procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë</p> <p>Më e shkurter se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë</p> <p>Më e shkurter ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë</p>
<b>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short</li> <li>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</li> <li>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</li> </ol>	Shumë e lartë	15	<p><b>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b></p> <p>Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë</p> <p>Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë</p> <p>1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë</p>
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short</li> <li>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</li> <li>3. Mendimi përfundimtar i</li> </ol>	Shumë e lartë	20	<p><b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b></p> <p>E dobët- 4 pikë</p> <p>Nën mesataren – 8 pikë</p>

		kryetarit			Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
<b>C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore</b>	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
<b>3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				100	Shkëlqyeshëm
<b>Tregues</b>	<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>	

<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	<b>Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit:</b> E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
<b>B. Integriteti i gjyqtarit</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	<b>Shkalla e integritetit të gjyqtarit :</b> E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
<b>C. Paanësia e gjyqtarit</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Nuk ka asnjë kërkesë të pranuar të palëve për përjashtim gjyqtari	15	<b>Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit:</b> Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
<b>4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>95</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	<b>Qartësia dhe transparencja e komunikimit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	<b>Respektimi i konfidencialitetit:</b> I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë

<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
<b>C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	Mbi 5 ditë (për periudhën 1 vjeçare)	20	<b>Pjesëmarrja e gjyqtarit:</b> (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	marredhëniet me publikun në gjykata	gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit			
	ç. Publikimi ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pike Ka të dhëna – 1 deri në 5 pike
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>			<b>389</b>		
<b>NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>			<b>Shkëlqyeshëm</b>		

**RELATOR**  
**BRUNILDA KADI**